



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3396 prot.

Himarë, më 21.07.2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 28, datë 21.07.2023

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Këshillit, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak të Himarës, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.02, datë 29.01.2021 “Mbi miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Himarë”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Këshilli Bashkiak Himarë, Kryetari i Bashkisë Himarë dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR

Dhimitër Kapaj

